



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 62, Datë 26.02.2026

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “PROINFINIT CONSULTING” SH.P.K. PËR HEQJEN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, gërma “dh” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, gërma “dh”, 7, paragrafi 2 dhe 9, gërma “d”, të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; pikës 5.1, gërma “dh”, të Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të Energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.02.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 468/1 prot., datë 26.02.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. për heqjen e licencave në veprimtarinë e furnizimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 558, seria T23, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 188, datë 06.06.2023, për një afat 5-vjeçar (deri më 06.06.2028)
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 468 prot., datë 03.02.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për revokimin e kësaj licence, për arsye se nuk e ka ushtruar veprimtarinë e licencuar.
- Në nenin 42, pika 1, gërma “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenin 5, gërma “dh”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 58, datë 18.04.2017; pikën 5.1, gërma “dh” të Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.06.2016, përcaktohet se: ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit.
- Në nenin 7, paragrafi 2 i Rregullores së sipërcituar përcaktohet se: Në rast se i licencuari është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje, ndërsa në nenin 9, gërma “d” të kësaj rregulloreje parashikohet se ...Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të

përcaktuara në pikat "dh" dhe / ose "e" të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.

- Rezulton se shoqëria nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s sa i përket pagesave të rregullimit.
- Për këto arsye dhe në rrethanat kur kërkesa për heqjen e licencës vjen nga vetë i licencuari, vlerësohet të vijohet me miratimin e saj dhe heqjen e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e shoqërisë “PROFINFINIT CONSULTING” sh.p.k. e humbet fuqinë juridike dhe hiqet dhe nga regjistri i licencave.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k., për heqjen e licencës nr. 558, seria T23, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr.188, datë 06.06.2023, për një afat 5-vjeçar.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar e humbet fuqinë juridike.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI